

**Bashkia:** KONISPOL

**Kryetar:** SHUAIP BEQIRI

**Fusha:** INFRASTRUKTURË DHE SHËRBIME PUBLIKE

**Premtime:**

1. Do të kryhet rehabilitimi i akseve kryesore që lidhin rrugët nacionale me tokat bujqësore
2. Do të përfundohet rehabilitimi i rrugëve të brendshme të fshatrave
3. Do të kryhet përmirësimi i infrastrukturës rrugore, sidomos në akset rrugore Ninat-Janjar, Shkallë-Vrinë, Shalës-Vërvë
4. Do të vendosen disa autoambulanca (brenda 10-15 minutash autoambulanca të jetë kudo brenda territorit të bashkisë)
5. Do të sigurohet pajisja me mjete të domosdoshme, mjekë dhe infermierë në të gjitha fshatrat
6. Do të zgjidhet problematika e ujërave të zeza që derdhen në kanalën kolektor dhe përfundojnë në liqenin e Butrintit
7. Do të kryhet furnizimi i rregullt me ujë të pijshëm në Konispol
8. Do të kryhet infrastrukturë rrugore në Konispol
9. Do të vendoset energji elektrike në Konispol
10. Do të kryhet rikonstruksioni i plotë i rrugës Vrinë-Shkallë
11. Do të përfundojë studimi i planit urbanistik
12. Do të zgjidhet çështja e tokave në fshatin Xarrë, ku 52 familjeve për shumë vite tokat u janë përmbytur nga liqeni i Butrintit
13. Do të zgjidhet problemi i pronësisë së tokës në Shkallë
14. Do të ndërhyet në infrastrukturën rrugore në Shkallë
15. Do të ndërhyet në infrastrukturën rrugore në Vrinë-Shkallë
16. Do të kryhet rehabilitimi i rrugëve të brendshme të fshatit Vrinë
17. Do të kryhet rehabilitimi i rrugëve të brendshme të fshatit Shëndëlli
18. Do të kryhet brenda vitit të parë të mandatit rruga e Janjarit
19. Do të kryhet rehabilitimi i rrugëve në Shalës
20. Do të kryhet ndërtimi i rrugës në Dishat
21. Do të kryhet furnizimi me ujë në Dishat
22. Do të kryhet rikonstruksioni i linjës elektrike në Dishat
23. Të gjitha tokat e fshatit Janjar dhe ju do të pajisen me certifikatë pronësie
24. Do të sigurohet furnizimi me ujë të pijshëm për çdo banor të fshatit Janjar
25. Do të riparohen shtyllat e tensionit në Janjar
26. Do të kryhet furnizimi i rregullt me ujë të pijshëm në Janjar, Ninat dhe Markat
27. Do të rikonstruktohet rruga Ninat-Janjar
28. Do të rikonstruktohet rruga Shalës-Vërvë

**Fusha:** ARSIM/KULTURË/SPORT

### **Premtime:**

1. Do të krijohen mjedise më të mira për fëmijët në territorin e bashkisë, që ata të kenë hapësirat e tyre të argëtimit dhe zhvillimit
2. Do të vendoset një linjë urbane pa pagesë në territorin e bashkisë për nxënësit dhe shpenzimet për transportin do t'i paguajë bashkia
3. Do të hapen shkolla profesionale në territorin e bashkisë, në bashkëpunim me qeverinë qendrore
4. Do të punohet për pajisjen e shkollave me kabinete, mjete didaktike dhe terrene sportive në territorin e bashkisë
5. Do të kryhet përmirësimi i infrastrukturës në të gjitha kopshtet dhe shkollat në territorin e bashkisë
6. Do të rikonstruktohen laboratorët në gjimnazin në Konispolit
7. Do të rikonstruktohet shkolla e Xarrës

### **Fusha: MJEDIS/TURIZËM**

#### **Premtime:**

1. Do të kryhet menaxhimi i integruar i mbetjeve urbane në territorin e bashkisë

### **Fusha: BUJQËSI**

#### **Premtime:**

1. Do të ketë zgjidhje ligjore problemi i kullotave për harmonizimin dhe rregullimin e marrëdhënieve ndërmjet blegtorëve, pronarëve, bashkisë dhe do të kryhet subvencionim i blegtorëve për stimulimin e rritjes së numrit të krerëve të bagëtive
2. Do të kryhet stimulimi i sektorit privat për ndërtimin e pikave moderne të grumbullimit dhe ruajtjes së prodhimit dhe mbështetja e fermerëve me subvencione
3. Do të kryhet përmirësimi i infrastrukturës rrugore në akset kryesore të plantacioneve
4. Do të kryhet pastrimi dhe vënia në funksion të kanaleve kulluese dhe vaditëse në territorin e bashkisë
5. Do të zgjidhet problemi i tokave të përmytura (Familjet që kanë pasur tokën e përmytur do të marrin të njëjtën sipërfaqe toke)
6. Do të kryhet marketingu i prodhimit bujqësor dhe blegtoral dhe do të krijohen lehtësira për bujqit dhe fermerët
7. Institucionet e varësisë si Ndërmarrja e Ujërave dhe Bordi i Kullimit do të reformohen për të vepruar me emergjencë për pastrimin dhe vënien në funksion të kanaleve kulluese dhe vaditës
8. Do të kryhet zhvillimi bujqësor dhe blegtoral, përmes mbështetjes me investime, subvencione dhe skema lehtësuese në Konispol
9. Do të kryhet hapja e kanaleve kulluese dhe vaditëse në Konispol
10. Do të stimulohet zhvillimi i bujqësisë dhe blegtorisë në Markat
11. Do të kryhet nxitja e zhvillimit të bujqësisë dhe blegtorisë në Shalës
12. Do të kryhet vënia në eficiencë e kanalit të Janjarit

**Fusha:** TRANSPARENCA

**Premtime:**

1. Zyra e Marrëdhënieve me Publikun do të jetë në mënyrë të vazhdueshme në shërbim rigoroz ndaj qytetarit
2. Mbledhjet e këshillit të bashkisë do të jenë të hapura për qytetarët, si dhe do të mundësohet ngritja e këshillit të qytetarëve. Do të sigurohet përfshirja në vendimmarrje e grupeve të interesit, në përputhje me detyrimet ligjore

**Fusha:** SHËRBIMET SOCIALE

**Premtime:**

1. Do të ketë një përfaqësim të drejtë të personave me besime te ndryshme fetare, në administratë, me qëllim që të ndjehen të gjithë të përfaqësuar

**Fusha:** EKONOMI DHE PUNËSIM

**Premtime:**